



Vepra lokalisht, mendo globalisht: Nje perspektive shqiptare

(Resource ID: 356)

Belina Bedini

belinabedini(at)yahoo.it

This teaching resource is allocated to following University:

UAMD - Aleksandër Moisiu University of Durrës

Institution:

Aleksander Moisiu University

<http://www.sustainicum.at/sq/modules/view/356.Vepra-lokalisht-mendo-globalisht-Nje-perspektive-shqiptare>



Puna ne grup



**Nuk ka
reindeksi
numri i
studenteve**



**Deri në 3 njësi
leksionesh**



Anglisht, Shqip

Ky material didaktik ka për qëllim të sjellë në qendër të vëmendjes së studentëve faktin se edhe Shqipëria është gjithashtu pjesë e globalizimit. Megjithëse jetojmë në një vend të vogël, me pak impakt në ekonomikë globale, ne jemi pjesë e ekonomisë globale. Ne duhet të jemi konkurrues në mënyrë që të mbijetojmë dhe të jemi të sukseshëm në jetën globale. Në fakt, nëpërmjet këtij materiali didaktik studentët do të nxiten që të fillojnë të mendojnë që ata gjithashtu janë aktorë të cilët mund të përfshihen në procesin e zhvillimit të ekonomisë. Kështu, ky material mësimor do t'u tregojë studentëve që aktivitete dhe iniciativa mbi zhvillimin e qëndrueshëm janë duke u ndërmarrë. Në këtë mënyrë ata do të

kuptojnë që edhe ata vetë mund të përfshihen në këto zhvillime. Nëpërmjet këtij leksioni të hapur, studentët do të marrin informacion mbi gjurmët e zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri. Për këtë arsye, gjatë mësimit të hapur pedagogu do të zhvillojë lojën "Bingo e Qëndrueshme". Kjo lojë do të mbajë gjallë vëmendjen e studentëve gjatë mësimit të hapur. Lektori do të përgatisë dhe shpërndajë disa bileta bingo tek studentët. Biletat do të kenë disa fjalë kyçe mbi zhvillimin e qëndrueshëm dhe globalizimin gjithashtu. Studentët do të shënojnë në biletat e tyre fjalët kyçe që janë përdorur gjatë leksionit të hapur. Në momentin që ndonjëri nga studentët do të ketë plotësuar të gjitha fjalët kyçe do të thërrasë "Bingo" e do të shpallet fitues.

Ky material didaktik do të përdoret gjatë kursit Dinamikat e Globalizimit. Ky kurs është pjesë integrale e kurrikulës së programit studimor Shkenca Politike të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Në bazë të silabusit, kursi trajton disa çështje shumë të rëndësishme të globalizimit si: ndryshimet e klimës, shfrytëzimi i burimeve natyrore, zhvillimi i qëndrueshëm, tregtia e lirë dhe e ndershme, inovacioni, varfëria në botë, roli i FMN, BB, OKB-së në procesin e globalizimit etj.

Megjithatë ky material mund të përdoret edhe në kurse të tjera që kanë lidhje me çështjet e globalizimit apo të zhvillimit të qëndrueshëm.

Ky material didaktik planifikohet të aplikohet rreth javëve të fundit të semestrit. Në këtë mënyrë studentët do të kenë të asimiluara disa informacione teorike mbi mënyrën se si funksionon globalizimi. Lektori do të ftojë një përfaqësues të RCE për një leksion të hapur. RCE është Qendra Rajonale e Ekspertizës për Edukimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kjo qendër është e vendosur në Tiranë dhe ka disa vjet që operon në Shqipëri. RCE ka ndërmarrë një sërë aktivitete dhe funksionon si një qendër informale. Është zgjedhur pikërisht kjo qendër pasi duam të tregojmë studentëve se edhe në një mënyrë informale, duke pasur idetë e duhuara ne mund të veprojmë për zhvillimin e vendit tonë.

Përfaqësuesi i RCE do të flasë me studentët mbi objektivat e qendrës, aktivitetet që qendra ka bërë dhe është duke zhvilluar, mënyra se si është e organizuar, çfarë ka arritur etj. Përfaqësuesi mund të bëjë një prezantim ku të tregojë fotografi apo video të ndryshme për të ilustruar aktivitetet e qendrës.

Megjithatë lektori i kursit mund të zgjedhë të ftojë përfaqësues të tjerë të

organizatave të ndryshme. Kjo varet kyressiht nga vendi ku kursi është organizuar (Shqipëri/Kosovë), por edhe nga kursi ku ky leksion i hapur do të integrohet.

Përpara se mësimi i hapur të fillojë, lektori do të bëj disa "Bileta Bingo" me disa fjalë kyçe mbi leksionet teorike që janë kryer në auditor. Këto bileta do t'u shpërndahen studentëve përpara se të fillojë leksioni i hapur. Biletat duhet të jenë të ndryshme për çdo student. Përshembull nëse do të jenë të pranishëm 35 studentë, duhet të përgatiten 35 bileta të ndryshme. Megjithatë disa fjalë kyçe të rëndësishme mund të përdoren në disa bileta.

Së pari lektori do të prezantojë organizatën e ftuar. Në të njëjtën kohë lektori do të prezantojë edhe përfaqësuesin nëpërmjet një përmbledhje të kurrikulumit të tij duke vazhduar më pas me prezantimin e çështjes që do të trajtohet në këtë leksion të hapur.

Pas prezantimit fjalët kyçe kryesore do të diskutohen së bashku me të ftuarin, duke i dhënë hapsirën e duhur një debati të gjerë në auditor. Studentet do të nxiten të hartojnë një projekt ide mbi zhvillimin e qëndrueshëm të zonës ku ata banojnë. Ky projekt mund të shërbejë si një detyrë kursi ku studenti mund të vlerësohet me 100 nga 1000 pikët e munshme të vleresimit final të kursit.

Përfitimet që i ftuari mund të ketë nga zhvillimi i këtij leksioni të hapur mund të jenë si më poshtë vijon:

Promovimi i organizatës në një audiencë të gjerë;

Promovim i aktiviteteve që janë kryer nga organizata në një ambient shkencor;

Marrja e një vlerësimi mbi aktivitete e ndërmarra deri në atë moment dhe mundësisht edhe marrja e disa ideve të që mund të shërbejnë për përmirësimin e këtyre aktiviteteve;

Marrja e ideve për aktivitete të reja;

Tërheqja e studentëve që mund të kenë interes të bashkëpunojnë me organizatën në mënyrë vullnetare apo për intership etj.

Mjetet e mësimdhënies



Mini-projekt për studentët



Case study



Lojë

Integrimi i palëve të interesuara shoqërore

Ky material didaktik integron njohuritë teorike të marra në klasë me një aktor konkret të zhvillimit të qëndrueshëm, pra me RCE. Pasi studentët kanë marrë informacionet dhe konceptet kryesore mbi globalizimin, tregun etj., ata kanë mundësinë të njihen nga afër me aktivitete konkrete mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë mënyrë ata mprehin aftësitë e tyre të mendimit kritik dhe në të njëjtën kohë mund të fillojnë të kenë një prespektivë të re mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Gjithashtu ata mund të vendosin të bashkohen me iniciativën e RCE si vullnetarë.

Pika e forte

Ky material didaktik u jep mundësi studentëve për të mësuar çfarë lloj aktiviteteve dhe iniciativave konkrete ka në vendin tonë përsa i përket zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë ata do të kenë mundësi të fillojnë të mendojnë në mënyrë globale, dhe ajo që është më e rëndësishme të veprojnë në mënyrë lokale.

Duke u njohur me qendrën RCE dhe me aktivitetet e saj studentët mund të hartojnë një projekt vetë. Ata do të mësojnë se duke pasur ide të reja, edhe me pak ose me mungesë financimesh ke mundësi për të ndërmarrë veprimtari të cilat mund të ndryshojnë jetën e tyre dhe të rajonit ku jetojnë. Studentët gjithashtu mund të bashkohen si vullnetarë në iniciativat e RCE-së dhe të bëhen edhe ata pjesë e ndryshimit.

Pika e dobët

Mangësia e këtij materiali mësimor qendron në faktin se nuk shkakton një impakt të menjëhershëm në zhvillimin e qëndrueshëm rajonal. Impakti është afat gjatë dhe ka të bëjë me mënyrën e të menduarit të studentëve. Në të njëjtën kohë materiali nuk sjell ndonjë produkt për t'u shpërndarë publikisht. Megjithatë aktivitetet publikues mund të bëhet nga vetë studentët nëpërmjet rrjeteve sociale.

Rezultatet e të mësuarit

Në përfundim të implementimit të këtij materiali didaktik studentët do të kenë mësuar:

1. Mbi iniciativat konkrete për zhvillimin e qëndrueshëm në vendin tonë;
2. Si mund të funksionojë një iniciativë mbi baza vullnetare si RCE në Shqipëri;
3. Si të mendojnë më shumë mbi globalizimin dhe si të veprojnë më shumë

për zhvillimin lokal.

Lidhja për qëndrueshmëri

Ky material didaktik është ngushtësisht i lidhur me qëndrueshmërinë sepse i jep mundësi studentëve të njihen konkretisht me aktivitetet dhe iniciativat mbi zhvillimin e qëndrueshëm. Në këtë mënyrë ata frymëzohen për të qenë më aktiv në iniciativa të tilla dhe në të njëjtën kohë zhvillojnë edhe më shumë mendimin e tyre kritik mbi zhvillimin e qëndrueshëm.

Njohuri paraprake

Asnje lloj njohurie paraprake specifike nuk kërkohet?

Përpyekjet e përgatitjes

Mesatare

Përshkrimi i përpyekjeve të përgatitjes

Ky material nuk kërkon shumë kohë për t'u përgatitur. Gjithsesi faza përgatitore përshkruhet në udhëzuesin bashkëngjitur. Mund të parashikohen rreth dy ore parapërgatitje për lektorin.

Aksesi

Free

Gjykimi / vlerësimi

Studentët të cilët do të hartojnë një projekt mbi një ide të tyre për zhvillimin e qëndrueshëm, do të vlerësohen me 100 pikë nga 1000 pikë të vlerësimit final

Kreditim/Çertifikatë

Nuk ka kredite

Burime dhe lidhje

<http://sustainicum.at/en/methods/view/26.Sustainability-Bingo>

<https://www.facebook.com/RCE-Albania-296156000446895/>

Financuar nga

This teaching resource, realised within the project ConSus, has been funded with the support of the TEMPUS of the European Union. The contents reflect the views of the authors, and the European Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein.